



vec f Rahovec

-Lokalet afariste janë në zonën kadastrale në Rahovec sipas certifikatës së pronësisë Nr.P-71510057-01341 janë në rr.” Avdullah Bugari ” në Rahovec në sipërfaqe prej **27 m², 12.80 m², 30 m², 30 m², 12.80 m², 15 m² dhe 51 m² dhe** lokalet afariste në zonën kadastrale në Rahovec sipas certifikatës së pronësisë Nr.P-71510057-00412-2 në rr.” Avdullah Bugari” në Rahovec në sipërfaqe prej **67 m² , 30 m², 10 m², 30 m², 30 m² dhe 12.80 m².**

2.0. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim janë në zonën kadastrale në fshatin Xërxe e evidentuar P.SH e Kosovës, me nr.të certifikatës së pronësisë si më poshtë:

1.1. Objektet te rezervat shtetërore -Xërxe , ngastra kadastrale nr. P-71510033-01043-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 900/m² (nëntëqindë metra katrorë) dhe 166 m² (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë metra katror).

2. Njoftimi për ankand publik përfshinë:

2.1. Çmimin fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit publik:

2.2. Çmimi fillestar për dhënien e pronës në shfrytëzim – Lokalet afariste në rr.”Xhelal Hajda”pn - Rahovec do të jetë 2.50 €/m².

2.3. Çmimi fillestar për dhënien e pronës në shfrytëzim – Lokalet afariste në rr.”Avdullah Bugari ”pn - Rahovec do të jetë 2.00 €/m².

- Çmimi fillestar për dhënien e pronës në shfrytëzim - **objektet te rezervat shtetërore** në fshatin Xërxe do të jetë **0.60 €/m².**

2.4. Afati i dhënies në shfrytëzim i pronës:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – **lokalet afariste në Rahovec (rr.” Xhelal Hajda”pn, dhe në rr.” Avdullah Bugari”pn.) dhe objektet te rezervat shtetërore në fshatin Xërxe** do të jetë afatshkurtër prej dhjetë (10) vitesh.

2.5. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet zyrës së prokurimit në Rahovec nga data: **29.06.2020, deri me datë: 29.07.2020 , nga ora 09:00 deri në ora 15:00.**

Vendi, koha ku do të mbahet ankandi publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal me dt.**03.08.2020** në fillim në ora **13:30**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

2.6. Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:

2.6.1. Lokali ose prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar në planin investiv dhe e njëjta nuk mund të bartet ne personin e tretë.

3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;

3.1. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

3.2. **Personat fizik** krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit (me afat) , dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë(jo më e vjetës se një muaj) dhe deklaratën nën betim të nënshkruar (ky dokument është pjesë e ankandit)

3.3. **Personat juridik**, krahas aplikacionit në kuvertë duhet ta bashkëngjisin edhe këto dokumente:

a. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata (NUI).

b. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,

c. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e cila ka afateshmëri.

d. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur (deklarata është pjesë e ankandit

3.1.Kritertët e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe objekteve komunale në fshatin Xërxe (rezervat shtetërore) Oferta ekonomikisht më e favorshme :

- Projekti investiv për 10 (dhjetë) vite**30 pikë**
- Çmimi më i lartë i qirasë mujore**30 pikë**
- Qiramarrësit aktual të cilët i kan kryer obligimet e qirasë (qiramarrësit aktual) **20 pikë**
- Gjenerimi i vendeve të reja të punës **15 pikë**
- Aplikuesi femër **5 pikë**
- **Kriteret vlejné për personat fizik dhe juridik.**

3.4. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- 3.4.1.** Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,
- 3.4.2.** Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- 3.4.3.** Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- 3.4.4.** Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- 3.4.5.** Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

4. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;

- 4.1.** Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
- 4.2.** Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:
 - 4.2.1.** Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
 - 4.2.2.** Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
 - 4.2.3.** Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
 - 4.2.4.** Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
 - 4.2.5.** Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.
- 5.** Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.
- 6.** Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.

7. Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e Komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 29.06.2020

Komisioni vlerësues i Ofertave